



RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**
për vitin 2017





RAPORT VJETOR

MBI VEPRIMTARINË

E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

për vitin 2017

Përgatitur nga Kuvendi i Shqipërisë



PËRMBAJTJA

HYRJE	7
KAPITULLI I VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE	9
KAPITULLI II KONTROLI PARLAMENTAR	16
KAPITULLI III FUNKSIONI ZGJEDHËS	20
KAPITULLI IV VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT	22
KAPITULLI V VEPRIMTARIA E KUVENDIT NË NGRITJEN E ORGANEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE DHE NGRITJEN E ORGANEVE TË REJA TË QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË	26
KAPITULLI VI DIPLOMACIA PARLAMENTARE	34
KAPITULLI VII TRANSPARENCA PARLAMENTARE	38
KAPITULLI VIII ADMINISTRIMI	41
PËRFUNDIME	51





HYRJE

Viti 2017 ka qenë një vit i rëndësishme në jetën parlamentare, pasi më 25 qershor 2017 u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë.

Kuvendi hapi punimet e Legjislaturës së 9-të më 9 shtator 2017.

Veprimtaria e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2017 është fokusuar në adresimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2016 dhe të takimit të tetë të Komitetit të Stabilizim-Asocimit Bashkimi Europian–Shqipëri të datës 4 tetor 2017, që lidhen me funksionimin e Kuvendit, reformën zgjedhore dhe reformën në drejtësi.

Roli legjislativ i Kuvendit është forcuar dukshëm. *Numri amendamenteve të propozuara nga deputetët gjatë shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve në komisionet e përhershme parlamentare është rritur.*

Transparenca në procesin legjislativ dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në këtë proces është rritur më tej.

Roli kontrollues i Kuvendit është forcuar më tej përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Kapacitetet institucionale dhe administrative të Kuvendit në çështjet e integritetit europian janë forcuar më tej përmes trajnimit të stafit të Kuvendit në fusha të ndryshme që lidhen me procesin e integritetit europian.

Kuvendi vijoi punën për miratimin e projektligjeve të reformës në drejtësi. Gjatë vitit 2017 u miratuan 8 projektligje nga paketa e 27 projektligjeve të kësaj reforme, duke e çuar në 15 numrin e ligjeve të miratuara deri tani nga kjo paketë ligjore.

Në seancën plenare të datës 30 nëntor 2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për buxhetin e vitit 2018 dhe 6 ligjet financiare që kanë lidhje me të. Ligji për buxhetin e vitit 2018 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë, përfshirë reformën në drejtësi, duke garantuar mbështetjen financiare dhe ngritjen e strukturave të këtyre institucioneve.

Në datën 13 tetor 2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi me konsensus vendimin për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Raporti vjetor për vitin 2017 paraqet një panoramë analitike të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë dhe është hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm.





Kapitulli 1

VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE

1.1. Legjislatura e re (9 shtator 2017–9 shtator 2021)

Kuvendi hapi punimet e Legjislaturës së 9-të më 9 shtator 2017 me një ceremoni të thjeshtë zyrtare në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10.599, datë 29.08.2017.

Përbërja e Kuvendit të ri pas verifikimit të mandateve dhe betimit të deputetëve rezulton:

Partia Socialiste e Shqipërisë – 74 deputetë

Partia Demokratike e Shqipërisë – 43 deputetë

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” – 19 deputetë

Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet” – 3 deputetë

Partia Socialdemokrate – 1 deputet

❖ Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit shënoi aktin më të parë në fillim të Legjislaturës. Me 80 vota pro, 40 kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi zgjodhi z. Gramoz Ruçi në krye të organit ligjvënës.

❖ Programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave

Pas betimit të deputetëve Kryeministri i Shqipërisë paraqiti në Kuvend programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave të dekretuar nga Presidenti i Republikës.

Votimi për miratimin e programit politik dhe përbërjes së qeverisë në bazë të Rregullores u bë i hapur. Me 78 vota pro, 51 kundër dhe asnjë abstenim qeveria “Rama” mori mandatin e saj të dytë.

❖ Konfigurimi i Kuvendit

Pas miratimit të programit politik dhe përbërjes së qeverisë u vijua me konfigurimin e Kuvendit të sapozgjedhur.

Kuvendi zgjodhi 2 zëvendëskryetarë: zonjën Vasilika Hysi (PS) dhe Edi Paloka (PD), si dhe organet e tjera drejtuese: Konferencën e Kryetarëve, Byronë e Kuvendit dhe sekretariatet e Kuvendit.

Në Kuvend u formatuan grupet parlamentare të mëposhtme:

- Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste – 74 deputetë, kryetar Taulant Balla;
- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike – 33 deputetë, kryetar Edmond Spaho;
- Grupi Parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integrim – 19 deputetë, kryetar Petrit Vasili;
- Grupi Parlamentar i Partisë Republikane – 7 deputetë, kryetar Fatmir Mediu.

7 deputetë u deklaruan të pavarur.



Në ushtrim të kompetencave të tij Kryetari i Kuvendi përcaktoi listat e anëtarëve dhe të kryesive të delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare, të grupeve të miqësisë si dhe formatimin e dy këshillave: Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe Këshilli për Legjislacionin.

Me vendimin nr. 86/2017 Kuvendi zgjodhi kryesitë e komisioneve të përhershme dhe me vendimin nr. 90/2017 përbërjen e tyre. Anëtarët zëvendësues të tyre u zgjodhën në një nga seancat e radhës.

1.2. Veprimtaria ligjvënëse

Gjatë vitit 2017 veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit, bazuar në objektivat institucionale dhe prioritetet sipas Planit të Veprimit, në zbatim të rekomandimeve të progresraporteve ka qenë intensive në përmbushje të kërkesave për reforma legjislative.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2017 aktiviteti parlamentar është zhvilluar në 45¹ seanca plenare.

Janë zhvilluar 1095 diskutime në 185 orë debat parlamentar, nga të cilat:

- shumica parlamentare ka zhvilluar 648 diskutime në 118,6 orë;
- pakica parlamentare ka zhvilluar 447 diskutime në 65,3 orë.

Viti 2017 ka qenë vit elektoral. Kuvendi i Shqipërisë ka ushtruar funksionet e tij në 2 legjislatura, 2 sesione të zakonshme dhe 3 sesione të jashtëzakonshme, konkretisht:

- Legjislatura VIII, sesioni i tetë (16 janar–5 maj 2017) dhe 3 sesione të jashtëzakonshme (22 maj 2017, 17 qershor 2017 dhe 24 korrik 2017);
- Legjislatura IX, sesioni i parë (9 shtator–18 dhjetor 2017).

Sesioni i parë i jashtëzakonshëm u mbledh më 22 maj 2017 me kërkesë të Kryeministrit për shqyrtimin dhe miratimin e disa çështjeve për vënien në zbatim të marrëveshjes politike të datës 18 maj 2017. Në bazë të kësaj marrëveshjeje palët u angazhuan për realizimin e zgjedhjeve me standarde demokratike, si pjesë thelbësore e kontributit të përbashkët dhe të vazhdueshëm të palëve në kuadër të çeljes së negociatave dhe përparimit të vendit në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Gjithashtu palët u angazhuan për përshpejtimin e procesit të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, me qëllim krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm dhe të drejtë, të pavarur e profesional, duke mundësuar kështu forcimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës si dhe integrimin në familjen e vendeve me demokraci të zhvilluar.

Sesioni i dytë i jashtëzakonshëm u mbledh më 17 qershor 2017 me kërkesë të një grupi deputetësh për zëvendësimin e deputetes Jorida Tabaku në komisionin *ad hoc* të përzgjedhjes me 12 anëtarë, për caktimin e anëtarëve zëvendësues në dy komisionet *ad hoc* të përzgjedhjes si dhe për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.


Sesioni i tretë i jashtëzakonshëm u mbledh më 24 korrik 2017 me kërkesë të Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, për zhvillimin e procedurës së betimit të Presidentit të ri të Republikës, z. Ilir Meta.

Kuvendi gjatë vitit 2017 ka miratuar gjithsej 246 akte, nga këto:

- 115 ligje;
- 116 vendime;
- 15 rezoluta.



Akte të miratuara




Krahasuar me vitin 2016 rezulton se gjatë vitit 2017 janë miratuar 27 ligje më pak, ndërsa vendime janë miratuar 18 më shumë.

Gjatë vitit 2017 në Kuvend janë depozituar 112 nisma ligjvënëse, nga të cilat:

- 87 nga Këshilli i Ministrave;
- 24 nga deputetët;
- 1 nga 37 mijë zgjedhës.

Projektligje



E shprehur në përqindje, 77% e nismave ligjvënëse kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave, 22% nisma të deputetëve dhe 0.1% nisma të zgjedhësve.

Aktualisht janë depozituar 119 projektvendime dhe 11 projektrezoluta.

Rezulton se gjatë vitit 2017 nga Këshilli i Ministrave janë depozituar 40 projektligje më pak në krahasim me vitin 2016, ndërsa nga deputetët janë depozituar 32 nisma ligjvënëse më pak. Kjo për faktin se viti 2017 ka qenë vit elektorale.

¹ Në vitin 2016 janë zhvilluar 46 seanca plenare në një shtirje kohore prej 371 orësh.



Funksioni ligjvënës ka konsistuar në miratimin e 115 ligjeve, nga të cilat:

- 51 prej tyre janë ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare apo aderime në konventa të ndryshme;
- 4 akte normative me fuqinë e ligjit;
- 96 nisma të Këshillit të Ministrave;
- 19 nisma deputetësh.

Nga këto:

- 8 nisma janë miratuar me shumicën e 3/5-ave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit;
- 51 nisma janë miratuar me votën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit;
- 56 nisma janë miratuar me shumicë të thjeshtë;
- 9 nisma janë për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Europian.

Opozita parlamentare ka dhënë konsensusin e saj për miratimin e 12 ligjeve².

Rezulton se 24 projektligje janë tërhequr³ gjatë vitit 2017 nga nismëtari, ndërkohë që projektligje e nisma të tjera vijojnë të jenë në procedurë parlamentare, duke u mbartur në programe dhe kalendarë pune.

❖ Ligje të shqyrtuara dhe të miratuara me procedurë të përsheptuar⁴

Gjatë vitit 2017 Kuvendi ka miratuar me procedurë të përsheptuar 7 projektakte. Nga këto:

- 6 projektligje me kërkesë të Këshillit të Ministrave;
- 1 projektvendim me kërkesë të 1/5-ave të deputetëve.

❖ Projektakte të shqyrtuara në seancë plenare në bazë të kërkesave për ndryshimin e rendit të ditës

Gjatë vitit 2017⁵ Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar me kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës 25 projektligje, 5 projektvendime, 1 akt normativ me fuqinë e ligjit dhe 2 dekrete për rishqyrtim ligji.

❖ Ligje të kthyera për rishqyrtim

Gjatë vitit 2017⁶ Presidenti i Republikës ka ushtruar të drejtën e vetos për kthimin edhe një herë në Kuvend për rishqyrtim për 1 ligj.

Kuvendi ka rrëzuar me vendim dekretin e Presidentit për ligjin e mëposhtëm:

• Vendim nr. 114/2017 “Për rrëzimin e dekretit nr. 10 656, datë 22.11.2017 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 98/2017 ‘Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë’»”.

Gjatë vitit 2017 Kuvendi ka pranuar dy dekrete të Presidentit të Republikës të paraqitura gjatë vitit 2016 për ligjet e mëposhtme:

• Vendim nr. 95/2017 “Për miratimin e dekretit nr. 9765, datë 14.10.2016 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 92/2016 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, i ndryshuar’»”.

• Vendim nr. 96/2017 “Për miratimin e dekretit nr. 9769, datë 18.10.2016 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 93/2016 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9640, datë 9.11.2006, ‘Për dhomat e tregtisë dhe industrisë’, i ndryshuar’»”.

❖ Nisma ligjvënëse të tërhequra nga nismëtari

Këshilli i Ministrave gjatë vitit 2017⁷ ka tërhequr 8 projektligje nga nismat e depozituara të këtij viti. Po ashtu 16 deputetë nismëtarë kanë tërhequr nismat e depozituara në Kuvend.



❖ Nisma ligjvënese të pamiratuara (të rrëzuara në parim)

Gjatë vitit 2017⁸ nuk ka pasur nisma ligjvënese të rrëzuara.

❖ Programet dhe kalendarët e punës së Kuvendit për vitin 2017

Programet e punës dhe kalendarët trejavorë, si mekanizma që Kuvendi i përdor në programimin e punimeve parlamentare, gjatë vitit 2017 rezultojnë se janë njoftuar apo miratuar në seancë plenare 7 programe pune dhe 10 kalendarë trejavorë të punës së Kuvendit.

❖ Çështjet e futura automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim

Gjatë vitit 2017⁹ janë futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim sipas periudhave të caktuara 31 nisma ligjvënese me karakter financiar dhe dekretet.

1.3. Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare


Për sesionin e fundit të Legjislaturës VIII dhe për sesionin e parë të Legjislaturës IX komisionet e përhershme kanë pasur një axhendë pune intensive si në aspektin e shqyrtimit të projektligjeve, ashtu dhe në forcimin e kontrollit parlamentar për zhvillimin e seancave dëgjimore për veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura, kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Për periudhën janar–dhjetor 2017 komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar dhe miratuar 149 akte ligjore, konkretisht: 43 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, përfshirë këtu edhe 4 akte normative, 20 nisma të reja ligjore, 52 marrëveshje, 13 projektrezoluta dhe 21 projektvendime.

Krahasuar me vitin 2016 rezultojnë se për vitin 2017 janë miratuar 27 ligje më pak.

E gjithë veprimtaria e punës së komisioneve parlamentare është zhvilluar në 298 mbledhje, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje 308 orë e 29 minuta. Rezultojnë se për vitin 2017 janë zhvilluar 184 mbledhje më pak se një vit më parë, por këtu duhet pasur parasysh fakti se viti 2017 ka qenë vit zgjedhor.

Në grafikun më poshtë paraqitet numri i mbledhjeve të zhvilluara nga komisionet gjatë viteve 2016 dhe 2017 si dhe numri i mbledhjeve për çdo komision gjatë këtyre viteve.



² Për vitin 2016 opozita ka dhënë pëlqimin e saj për 33 projektligje.

³ Për vitin 2016 rezultojnë se janë tërhequr nga nismëtari 5 projektligje.

⁴ Për vitin 2016 shifra është e njëjtë.


⁵ Për vitin 2016 rezultojnë 4 projektakte.

⁶ Për vitin 2016 rezultojnë 6 ligje të kthyer.

⁷ Për vitin 2016 rezultojnë se 5 projektligje janë tërhequr nga nismëtari: 4 nga KM dhe 1 nga deputetët.


⁸ Për vitin 2016 rezultojnë 2.

⁹ Për vitin 2016 rezultojnë 21.




Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së komisioneve të përhershme parlamentare gjatë vitit 2017 ka qenë edhe organizimi i seancave dëgjimore jo vetëm për procesin legjislativ, por dhe për procesin zgjedhës e kontrollin parlamentar, si dhe seanca të zhvilluara me grupet e interesit me kërkesën e këtyre të fundit.

Në periudhën janar–dhjetor 2017 komisionet parlamentare kanë zhvilluar 154 seanca dëgjimore, nga të cilat 65 për procesin legjislativ, 15 seanca për procesin zgjedhës, 42 seanca për kontroll parlamentar dhe 32 seanca me grupet e interesit.




Në grafikun më poshtë paraqitet numri i seancave dëgjimore për vitin 2017 krahasuar me vitin pararendës.





Në kuadër të detyrave të koordinatorit me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, me qëllim përditësimin e regjistrimit elektronik dhe rritjen e interesit për të qenë pjesë e tij, bazuar në vullnetin e aktorëve të interesit, më poshtë janë pasqyruar kërkesat për regjistrim.

KËRKESA TË OSHC-VE PËR REGJISTRIM PËR VITIN 2017



Në përfundim të shqyrtimit të nismave ligjore komisionet parlamentare kanë miratuar 576 amendamente, të cilat janë paraqitur për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.



Kapitulli 2


KONTROLLI PARLAMENTAR

Veprimtaria e komisioneve dhe seancës plenare gjatë vitit 2017 është shtrirë edhe në drejtim të ushtrimit të kontrollit parlamentar të Kuvendit ndaj pushtetit ekzekutiv dhe forcimit të rolit kontrollues të Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Komisionet e përhershme parlamentare gjatë vitit 2017 kanë organizuar 42 seanca dëgjimore për kontroll parlamentar.

Kuvendi ka ushtruar kontroll mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve të tilla ligjore bashkëkohore si: interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore për çështje të zbatueshmërisë së ligjeve, komisione hetimore, seancës së pyetjeve etj.

Kontrolli parlamentar në seancë plenare gjatë kësaj periudhe paraqitet si vijon:



❖ Interpelancat

Në kuadër të kompetencave të kontrollit vlejné të theksohet kontrolli që Kuvendi ka ushtruar mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumentit më të rëndësishëm të kontrollit parlamentar: interpelancës. Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 3 interpelanca si vijon:

- Me ministren e Kulturës, kërkuar nga deputeti Alket Hyseni lidhur me bazueshmërinë ligjore, procedurat e ndjekura si dhe impaktin në mjedis dhe në komunitet për zbatimin e projekteve të ndërtimit të Qendrës Multifunksionale të Shërbimit dhe Këndit SAL në Parkun Kombëtar të Butrintit.



- Me ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kërkuar nga deputeti Erion Braçe lidhur me politikat e Ministrisë për kostot, çmimet e grumbullimit, shitjen me pakicë, eksportin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në vend.

- Me ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kërkuar nga deputeti Erion Braçe lidhur me gjendjen aktuale për kontratat e dhënies së tokave bujqësore me qira, ligjshmërinë dhe efektivitetin e tyre, veçanërisht në aspektin e prodhimit, sasisë, llojshmërisë, eksportit dhe punësimit në to, si dhe politikat që do të ndjekë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

❖ **Kërkesa për informacion**

Ky instrument kontrolli vazhdon të paraqitet shumë dominues në krahasim me mjetet e tjera të kontrollit.

Gjatë vitit 2017 numërohen 57 kërkesa drejtuar titullarëve të institucioneve shtetërore dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Kryesisht janë kërkuar nga deputetët e opozitës.

Janë marrë përgjigje për 40 prej tyre.

❖ **Rezolutat**

Gjatë vitit 2017 Kuvendi ka miratuar 15 rezoluta, nga të cilat:

- 13 rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2016, si dhe u ka caktuar atyre objektivat që duhet të arrijnë për vitin 2017;

- 2 rezoluta me objekt dënimin e fenomenit të dhunës në familje dhe marrjen e masave urgjente për evidentimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikasë ligjorë për parandalimin e këtij fenomeni, si dhe rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të *Axhendës 2030* të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

❖ **Roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj veprimtarisë së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj**

Gjatë vitit 2017 organet e Kuvendit përmes komisioneve të përhershme parlamentare dhe nënkomisioneve kanë përdorur instrumente parlamentare për informimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, si:

- gjatë fazës së raportimit vjetor të institucioneve të pavarura;
- gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve;
- lidhur me propozimet për ndryshime në strukturat e institucioneve të pavarura;
- gjatë informimit periodik dhe njohjes së problematikave nga organet e Kuvendit, si dhe gjatë konsultimeve të gjera në procesin ligjvënës;
- në marrjen e nismave për të krijuar mekanizma të rinj efikasë për të përmbushur objektivat e integritetit;
- gjatë procesit zgjedhës dhe emërues.

1. Në zbatim të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit si dhe të neneve respektive në ligjet organike të institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend, bazuar në kalendarin e raportimit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve në janar 2017, janë paraqitur raportet vjetore të institucioneve të pavarura si dhe një raport i institucionit të varësisë së ekzekutivit në kuadër të kontrollit parlamentar dhe atij



ligjor, por të lidhura me fushën e veprimtarisë dhe zbatimit të ligjit nga institucione të pavarura.

Raportet vjetore u janë përcjellë komisioneve parlamentare përgjegjëse për shqyrtimin e veprimtarisë vjetore të punës gjatë vitit 2016 nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Medieve Audiovizive, Avokati i Popullit, Banka e Shqipërisë, Departamenti i Administratës Publike për gjendjen në Shërbimin Civil, Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Radiotelevizioni Shqiptar.

Në referim të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, komisionet parlamentare kanë zhvilluar 16 mbledhje për prezantimin e raportit vjetor, seanca pyetje-përgjigjesh e diskutime dhe 13 mbledhje për miratim projektrezolutash, të cilat janë përcjellë për miratim në seancë plenare.

Në seancat plenare janë miratuar 13 rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Kuvendi nëpërmjet rezolutave të miratuara ka adresuar detyra me afate konkrete për institucionet përkatëse, duke bërë kështu të mundur një monitorim më efektiv të veprimtarisë së këtyre institucioneve dhe rritjen e rolit të tij mbikëqyrës.

Kjo veprimtari e Kuvendit është vlerësuar edhe në raportin e fundit të Komisionit European.

Komisionet parlamentare, në zbatim të nenit 102 të Rregullores, kanë zhvilluar kontroll parlamentar për zbatimin e legjislacionit dhe aktivitetin institucional për institucione të ndryshme shtetërore, si: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik; Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; Komisioni për Sigurinë Kombëtare; Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

2. Buxheti dhe struktura e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

- *Janë zhvilluar 10 seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura buxhetore gjatë fazës së shqyrtimit dhe miratimit të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2017*, si: Autoriteti për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Autoriteti i Konkurrencës, Avokati i Popullit, KQZ-ja, Prokuroria e Përgjithshme, ILDKPKI-ja, KMD-ja, KMSHC-ja, KDIMDP-ja, RTSH-ja, ISKK-ja. Për disa institucione komisionet përgjegjëse kanë mbështetur kërkesat e tyre për shtimin e fondeve buxhetore.

Janë shqyrtuar dhe miratuar me vendime të Kuvendit struktura e re e Autoritetit të Konkurrencës dhe ajo e ERRU-së.

- Janë shqyrtuar dhe miratuar me vendime të Kuvendit struktura dhe organika e tri institucioneve të reja të ngritura në kuadër të zbatimit të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, përkatësisht të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerit Publik.

3. Mekanizmi i ri ndërinstytucional Kuvend–qeveri–institucione të pavarura

Në kuadër të raportit të Komisionit European për vitin 2016, në të cilin thuhej se *ende duhet të zhvillohet një ndjekje (follow-up) e plotë dhe një sistem monitorimi i rekomandimeve nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura, por dhe në përmbushje të objektivave të vetë Kuvendit në këtë drejtim*, u ndërмор nisma që në nëntor 2016 me organizimin e tryezës së rrumbullakët “*Kuvendi dhe institucionet e pavarura: identifikimi i mekanizmave institucionalë për ndjekjen dhe zbatimin efikas të rekomandimeve të institucioneve të pavarura*”, me fokus kryesor ato në fushën e të drejtave dhe të auditimit publik.



Kuvendi i Shqipërisë në datën 20 prill 2017 miratoi vendimin nr. 49/2017 të tij për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, i botuar në “Fletoren zyrtare” nr. 90, datë 27.04.2017.

Ky mekanizëm synon që Kuvendi të jetë institucion gjithëpërfshirës, i përgjegjshëm në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të promovojë edhe më shumë llogaridhënien e institucioneve shtetërore dhe atyre të pavarura, sidomos atyre që nxitin dhe promovojnë të drejtat e njeriut dhe ato që kanë fokus parandalimin e korrupsionit e në të njëjtën kohë përfaqësimin e duhur të tyre në vendimmarrje.

Këto janë qëllime që përkrijnë edhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara të miratuara me rezolutën e Kuvendit më 4 dhjetor 2017.

Me fillimin e legjislaturës së re, në datën 19 dhjetor 2017 Kryetari i Kuvendit organizoi takimin e parë ndër-institucional me institucionet e pavarura, që shënoi fillimin e zbatimit të përbashkët ndër-institucional të mekanizmit Kuvend–qeveri–institucione të pavarura, miratuar me vendim të Kuvendit nr. 49/2017. Në takim kishte të ftuar edhe përfaqësues të Këshillit të Ministrave, deputetë dhe të ftuar nga përfaqësuesitë e organizmave ndërkombëtarë në vend (OSBE, BE, KE, OPDAT, EURALIUS, UNICEF), nga shoqëria civile dhe media.

Në lidhjet shoqëruese të këtij vendimi janë parashikuar masa për organet e Kuvendit, ato të ekzekutivit, institucionet e pavarura dhe shërbimet mbështetëse të Kuvendit.

Pa vonesë ka filluar koordinimi dhe bashkëpunimi i organeve dhe institucioneve të përfshira për zbatimin e këtyre masave. Për këtë:

- janë zhvilluar takime me zëvendëskryetaren e Kuvendit dhe zëvendëskryeminstren, e cila ka në fushën e saj të përgjegjësisë marrëdhëniet me Kuvendin për masat që duhet të marrë Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të mekanizmit për veprimet e qeverisë;

- u është komunikuar në mënyrë institucionale titullarëve të institucioneve të pavarura që të caktojnë nga një përfaqësues në nivel vendimmarrës, që do të jetë pikë kontakti dhe bashkërendimi në vijimësi për masat e parashikuara në këtë mekanizëm ndër-institucional me Kuvendin e Shqipërisë;

- u është komunikuar të gjithë kryetarëve të komisioneve parlamentare që, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kompetencave që kanë, të zbatojnë masat që janë parashikuar për komisionet në mekanizmin ndër-institucional të miratuar nga Kuvendi.

Ky mekanizëm do të japë rezultatet konkrete pas zbatimit të tij gjatë vitit 2018.



Kapitulli 3


FUNKSIONI ZGJEDHËS

Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i titullarëve dhe anëtarëve të institucioneve monokratike dhe kolegjiale, kushtetuese dhe të krijuara me ligj është një detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet organike.

Komisionet e përhershme parlamentare, në zbatim të neneve 111, 114 dhe 115 të Rregullores së Kuvendit, kanë shqyrtuar përmbushjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidaturave të paraqitura dhe kanë vlerësuar meritën dhe profesionalizmin mbi bazën e respektimit të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Kuvendi në seancë plenare ka marrë:

- 12 vendime për miratimin e dekreteve për emërim ministri;
- 11 vendime për miratimin e dekreteve për shkarkim ministri;
- 4 vendime për zgjedhje në institucionet kushtetuese;
- 9 vendime për zgjedhje në institucione të krijuara me ligj;
- 2 vendime për moszgjedhje në institucione të krijuara me ligj;
- 1 vendim për shkarkim nga detyra në institucione të krijuara me ligj;
- 1 vendim për lirim nga detyra në institucione të krijuara me ligj.



Procesi zgjedhës i Kuvendit për plotësimin e vakancave në organet kolegjiale dhe/ose titullarëve në institucionet monokratike, kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj

Gjatë vitit 2017 Kuvendi e ka ushtruar funksionin zgjedhës në rastet kur janë zgjedhur:



- **Presidenti i Republikës.** Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 53/2017, datë 28.04.2017, pas zhvillimit të tri raundeve të votimit për Presidentin e Republikës, zgjodhi në raundin e katërt me 87 vota “pro” z. Ilir Meta President të Republikës së Shqipërisë.

- **Avokati i Popullit.** Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 70/2017, datë 22.05.2017, bazuar në nenin 61 të Kushtetutës, nenet 3, 4 dhe 9 të ligjit nr. 8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit, i ndryshuar” dhe nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij zgjodhi znj. Erinda Ballanca në krye të institucionit të Avokatit të Popullit.

- **Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm.** Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 115/2017, datë 18.12.2017, në zbatim të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 109, pika 2 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, caktoi prokuroren Arta Marku që të kryejë përkohësisht funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjithashtu Kuvendi e ka ushtruar funksionin zgjedhës edhe në rastet kur janë zgjedhur:

- dy anëtarë të Bordit të ERE-s;
- dy anëtarë të AKEP-it, njëri prej të cilëve u emërua kryetar;
- një anëtare e Autoritetit të Konkurrencës;
- një anëtar i Bordit të AMF-së në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv;
- një anëtar dhe kryetari i KQZ-së;
- 27 anëtarët e zgjedhur në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit nr. 84/2016.

Ndërkohë gjatë vitit 2017 komisionet përgjegjëse parlamentare “(Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut) kanë zhvilluar seanca të shumta dëgjimore me 108 kandidatë gjatë procesit të plotësimit të vakancave në institucione të ndryshme të pavarura dhe për krijimin e institucioneve të reja, si dhe kanë nisur procedurat e përcaktuara në ligj dhe Rregulloren e Kuvendit për plotësimin e vakancave të krijuara, duke synuar parimin e transparencës dhe të gjithëpërfshirjes në kandidim.

Komisioni *ad hoc* i ngritur në zbatim të ligjit nr. 84/2016 ka kryer procedurat e verifikimit të (68) kandidatëve, që më pas u janë përcjellë dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes me 6 dhe 12 anëtarë, të cilët kanë kryer procedurat e tyre të votimit sipas ligjit nr. 84/2016.

Gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të kandidaturave organet e Kuvendit kanë zbatuar me përpikëri detyrimet ligjore që rrjedhin në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 dalë në zbatim të këtij ligji si dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Në çdo rast janë administruar formularët e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatët sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 dhe ligjit nr. 45/2015, për të cilat është bërë verifikimi nga autoritetet përgjegjëse të ligjit. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 gjatë këtyre procedurave është bërë publikimi i formularëve të vetëdeklarimit për çdo kandidat në faqen zyrtare të Kuvendit.



Kapitulli 4

VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT

❖ Veprimtaria e organeve drejtuese të Kuvendit

Gjatë vitit 2017 organet drejtuese kanë zhvilluar mbledhje për trajtimin e çështjeve të ndryshme që, sipas Rregullores, janë në kompetencën e tyre:

- *Konferenca e Kryetarëve* ka zhvilluar 21¹⁰ mbledhje për miratimin e programit të punës, të kalendarit trejavor, kalendarit të raportimeve të disa institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, kalendarit të shqyrtimit të projektbuxhetit dhe paketës fiskale, kërkesa për ndryshimin e rendit të ditës, për ngritjen e komisioneve të posaçme, propozime për ndryshime në komisionet e përhershme, kërkesa nga grupet parlamentare etj. Konferenca ka miratuar me mirëkuptim ose i ka dërguar në seancën plenare për miratim në rastet kur nuk është arritur mirëkuptimi 7 programe 6-javore dhe 9 kalendarë trejavorë si dhe 1 kalendar njëjavor.

- *Byroja e Kuvendit* ka zhvilluar 7 mbledhje për çështje administrative dhe funksionim të brendshëm të Kuvendit, masa disiplinore ndaj deputetëve që kanë shkelur rëndë Rregulloren në seancë plenare etj.

- *Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin* ka zhvilluar 8 mbledhje për çështjet: verifikim mandati, kërkesat e prokurorit për dhënie autorizimi për arrestim dhe heqje lirie të deputetit, shqyrtim i propozimeve për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit dhe projekt Kodi i sjelljes së deputetëve.

❖ Krijimi i strukturave të reja parlamentare

Gjatë vitit 2017¹¹ përveç strukturave bazë për zhvillimin e veprimtarisë së tij Kuvendi ka krijuar edhe 6 struktura të përkohshme parlamentare si më poshtë:

- me vendimin nr. 45/2017 ngriti komisionin *ad hoc* me 12 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

- me vendimin nr. 46/2017 ngriti komisionin *ad hoc* me 6 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

- me vendimin nr. 113/2017 ngriti Nënkomisionin e përhershëm parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas”;

- me vendimin nr. 99/2017 ngriti Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;



- me vendimin nr. 98/2017 ngriti Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në përbërje të Komisionit për Politikën e Jashtme.

- me vendimin nr. 102/2017 ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

❖ Grupet vullnetare

Kuvendi ka ngritur grupet vullnetare të deputetëve si vijon:

- grupi “Miq të e Fëmijëve”;

- grupi “Aleanca e Grave Deputete”.

Të dyja grupet janë konstituar dhe vazhdojnë veprimtarinë e tyre.

❖ Lëvizjet në grupe parlamentare

Gjatë vitit 2017¹² nuk ka pasur ndryshime në përbërjen e grupeve parlamentare.

❖ Mbarim mandati¹³

• *Për shkak të dorëheqjes për arsye personale*

Gjatë vitit 2017 kanë hequr dorë nga mandati tre deputetë.

• *Për shkak të heqjes së mandatit në zbatim të ligjit të dekriminalizimit*

Gjatë vitit 2017 u është ndërprerë mandati para kohe dy deputetëve.

• *Mbarim mandati për arsye të ndarjes nga jeta*

Gjatë vitit 2017 u nda nga jeta një deputet.

❖ Mandate të reja

Gjatë vitit 2017 janë krijuar 7 vakanca, të cilat me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe pas verifikimit nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë plotësuar me 7 deputetë të rinj.

❖ Dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banese për deputetë të Kuvendit të Shqipërisë¹⁴

Gjatë vitit 2017 në Kuvend është paraqitur një kërkesë për dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal dhe banese nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

¹⁰ Gjatë vitit 2016 Konferenca e Kryetarëve ka zhvilluar 18 mbledhje, Byroja e Kuvendit 8 mbledhje dhe Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin 4 mbledhje.

¹¹ Gjatë vitit 2016 janë ngritur 4 struktura të reja.

¹² Në vitin 2016 ka pasur 4 raste të largimit nga grupi parlamentar.

¹³ Në vitin 2016 rezultojnë 2 raste.

¹⁴ Në vitin 2016 nuk është paraqitur asnjë kërkesë.



Kuvendi me vendimin nr. 104/2017, në mbështetje të nenit 73, pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës, të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5 të Rregullores së Kuvendit, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për:

- dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës për një deputet të Kuvendit;
- dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar, si masë shtrënguese të heqjes së lirisë në kuptim të shkronjave "a", "b" dhe "c" të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale;
- rrëzimin e kërkesës së prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për një deputet të Kuvendit në kuptim të shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale.

❖ **Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integrimit europian**

Integrimi europian është një proces i gjerë dhe sfidues, që kërkon realizimin e reformave transformuese dhe gjithëpërfshirëse, të cilat mundësojnë përballimin e suksesshëm të detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Europian (BE). Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në vend, luan një rol kyç në procesin e integrimit europian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të tij.

Gjatë vitit 2017 Kuvendi ka vijuar të forcojë rolin e tij shqyrtues lidhur me kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar. Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur Komisioni për Integrimin Europian (KIE), i cili gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar dhe miratuar 13 projektligje, ka propozuar 31 amendamente për përafimin më korrekt të tyre me *acquis* të BE-së. Këto amendamente janë reflektuar në raportet përkatëse të KIE-së dhe janë miratuar nga Kuvendi edhe në seancë plenare. Nga 13 projektligjet e shqyrtuara dhe të miratuara nga Komisioni për Integrimin Europian dhe Kuvendi 9 prej tyre synonin përafimin e pjesshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së.

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE), si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian dhe si një instrument i rëndësishëm për sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse lidhur me reformat integruese të vendit, ka vijuar të forcojë më tej rolin kontrollues të Kuvendit në procesin e integrimit europian.

Gjatë vitit 2017 veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian është fokusuar në:

- monitorimin e zbatimit të detyrimeve të anëtarësimit;
- nxitjen e dialogut të vazhdueshëm me grupet e interesit për procesin e integrimit europian;
- forcimin e kapaciteteve institucionale për integrimin europian.

Në kuadër të ***monitorimit të zbatimit të detyrimeve të anëtarësimit***, Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian ka diskutuar me anëtarët dhe të ftuarit e përhershëm të tij për ecurinë e detyrimeve të anëtarësimit e veçanërisht të 5 prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Gjithashtu, po në drejtim të monitorimit të detyrimeve të procesit të integrimit, gjatë vitit 2017 Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian ka analizuar dhe ka dhënë sugjerimet përkatëse për dokumentet e mëposhtme strategjike:

- Plani Kombëtar i Integrimit Europian 2017–2020;
- Plani i Veprimit për adresimin e rekomandimeve afatshkurtra të raportit të Komisionit Europian



për Shqipërinë për vitin 2016;

- raporti i detajuar i Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Europian dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi Europian dhe donatorë të tjerë për vitin 2016;

- raportet tremujore të hartuara nga Ministria e Integritimit Europian;

- Dokumenti Konceptual lidhur me negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, hartuar nga Ministria e Integritimit Europian.

Referuar *nxitjes së dialogut të vazhdueshëm për procesin e integritimit europian*, Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian i ka kushtuar vëmendje rolit të rëndësishëm që ky Këshill ka në garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike dhe institucioneve publike, por dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, botën akademike dhe të gjitha grupet e interesit të shoqërisë. Në këtë kuadër janë organizuar takime të ndryshme tematike me qëllim diskutimin me grupet e ndryshme të interesit mbi sfidat e procesit të integritimit europian dhe rëndësinë e përfshirjes aktive të tyre në këtë proces. Këto takime synojnë promovimin e përmirësimit të njohurive mbi procesin e integritimit europian, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe nxitjen e dialogut me grupet përkatëse të interesit mbi kapitujt kryesorë të legjislacionit të Bashkimit Europian.

Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian ka qenë mjaft aktiv edhe në drejtim të *forcimit të kapaciteteve institucionale për çështjet e integritimit europian*.

Një nga iniciativat mjaft të suksesshme të KKIE-së është organizimi vjetor i Shkollës Verore Europiane (SHVE), e cila synon identifikimin e aktorëve të mundshëm në ndihmë të ekipit negociator për anëtarësimin e Shqipërisë në BE si dhe krijimin e një grupi të konsoliduar ekspertësh me njohuri të thella mbi procesin e vendimmarrjes dhe anëtarësimin në BE. Shkolla Verore Europiane 2017, miratuar me vendim të Byrosë së Kuvendit nr. 107, datë 09.03.2017, u organizua në partneritet me Delegacionin e Bashkimit Europian në Tiranë, fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe fondacionin “Friedrich Ebert” në datat 4–8 shtator 2017.

Me qëllim forcimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit me shoqërinë civile, por edhe rritjen e kapaciteteve të saj, si një nga partnerët më të rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integritimit, gjatë zhvillimit të dy raundeve të Shkollës Verore Europiane iu kushtua rëndësi përfshirjes në të të individëve të spikatur nga shoqëria civile dhe bota akademike.



Kapitulli 5

VEPRIMTARIA E KUVENDIT NË NGRITJEN E ORGANEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE DHE NGRITJEN E ORGANEVE TË REJA TË QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Ndryshimet kushtetuese të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 22 korrik 2016 sjellin ndryshime të rëndësishme në mënyrën e organizimit të organeve të sistemit të drejtësisë dhe kompetencat përkatëse të tyre, duke parashikuar mekanizma konkretë që do të garantojnë funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Në këtë aspekt amendamentet kushtetuese dhe paketa e ligjeve prioritare të reformës në drejtësi i japin Kuvendit të Shqipërisë një rol të rëndësishëm në ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

1. KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet 147 dhe 149 parashikon ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këto organe përbëhen nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë dhe joprokurorë, përkatësisht për çdonjërin nga këto dy organe:

- 2 anëtarë nga radhët e avokatëve;
- dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës;
- një anëtar nga shoqëria civile.

Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në procesin e konstituimit të këtyre organeve i ka dhënë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë detyra dhe kompetenca të karakterit *formalo-procedurale (neni 147 dhe 149, pika 4 e Kushtetutës) dhe substanciale (nenet 147 dhe 149, pikat 5 dhe 6 të Kushtetutës)* për verifikimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore për përzgjedhjen e pesë kandidatëve nga radhët e jogjyqtarëve dhe joprokurorëve, kompetenca këto të detajuara më tej në ligjin përkatës nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Pas shpalljes së datës 13 janar 2017 në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë për paraqitjen e shprehjes së interesit nga kandidatët për KLGJ-në dhe KLP-në nga radha e avokatisë, trupës së pedagogëve, shoqërisë civile, procesi i kandidimeve dhe verifikimeve të tyre nga organet që përcaktan ligji është kryer gjatë periudhës shkurt–29 dhjetor 2017, data e fundit kur u dorëzuan në Kuvend nga Komisioni i Shoqërisë Civile kandidatët nga shoqëria civile për KLP-në.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në mbështetje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, pas paraqitjes së kandidaturave nga komisionet *ad hoc* dhe mbledhja e posaçme e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë dhe Shkollës së Magjistraturës, vijoi me ushtrimin e kompetencave të tij për:



- *verifikimin e plotësisimit të kushteve kushtetuese dhe ligjore;*
- *vlerësimin e përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale nga kandidatët bazuar në procesin e zhvilluar nga komisionet ad hoc dhe mbledhja e posaçme si dhe nga dokumentacioni i gjendur në dosjet e secilit kandidat.*

Gjatë fazës së verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe afateve ligjore për të gjithë kandidatët Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë ka zbatuar parashikimet kushtetuese dhe ligjore duke:

- *verifikuar dosjen e çdo kandidati* dhe në rastin kur janë konstatuar mangësi në dokumentacion i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit brenda një afatit 5-ditor;
- *kërkuar verifikimin e fakteve të vetëdeklaruarra pranë institucioneve ligjzbatuese;*
- *mbledhur dokumentacionin e plotë nga kandidatët dhe institucionet ligjzbatuese* me vlerësimin e plotësisimit të kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe më tej me vlerësimin profesional e moral vetëm të kandidatëve që kanë plotësuar kushtet ligjore;
- *bashkëpunuar dhe koordinuar gjatë procesit të verifikimit me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit*, si një organ i parashikuar në dispozitat kalimtare të Kushtetutës, përkatësisht neni 179, pikat 5 dhe 6.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në përfundim të procesit të verifikimit të plotësisimit të kushteve kushtetuese dhe ligjore dhe vlerësimin të shkallës së përmbushjes së kritereve morale e profesionale nga kandidatët ka depozituar pranë Komisionit parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend 6 raporte vlerësimi, përkatësisht:

- *Në datën 05.06.2017* i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut raportin e vlerësimin për kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga avokatia, shoqëruar me listën dhe dosjet e kandidatëve, vlerësimin e ONM-së dhe praktikën e paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimin.

- *Në datën 21.07.2017* i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut raportin e vlerësimin për kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga shoqëria civile, shoqëruar me listën dhe dosjet e kandidatëve, vlerësimin e ONM-së dhe praktikën e paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimin.

- *Në datën 15.08.2017* i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut raportin e vlerësimin për kandidatët nga avokatia për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, shoqëruar me listën dhe dosjet e kandidatëve, vlerësimin e ONM-së dhe praktikën e paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimin.

- *Në datën 02.11.2017* i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dy raportet e vlerësimin për kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve, shoqëruar me listën dhe dosjet e kandidatëve, vlerësimin e ONM-së dhe praktikën e paraqitur nga mbledhja e posaçme e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë.

- *Në datën 15.01.2018* i ka përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportin e vlerësimin për kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile, shoqëruar me listën dhe dosjet e kandidatëve, vlerësimin e ONM-së dhe praktikën e paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimin.

Me përfundimin e vlerësimin nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të kandidatëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile përfundon në tërësi procesi i vlerësimin për të gjithë kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, pedagogëve dhe shoqërisë civile.



Veprimtaria e Nënkomisionit për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi u njoh me raportimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit për përfundimin prej tij të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve, në zbatim të pikës 19 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 në datën 17.01.2018 miratoi rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Nënkomisionit për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në datën 18.01.2018, pas caktimit të përfaqësuesve nga tri grupet parlamentare, komisioni vendosi në unanimitet krijimin e Nënkomisionit të Përzgjedhjes së Kandidatëve me vendimin nr. 2, datë 18.01.2018.

Në datën 22.01.2018, bazuar në pikën 15 të nenit 35 të ligjit 115/2016 Nënkomisioni zhvilloi procesin e diskutimit dhe miratimit të listës së kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë si dhe votimin e kandidatëve. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për secilën nga listat e hedhura për votim për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mori minimumin prej 4 votash, të nevojshme për t’u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit. Për pasojë Nënkomisioni përzgjodhi nëpërmjet procedurës së shortit 5 kandidatët jogjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe 5 kandidatët joprokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe ia përcolli listat e kandidatëve Kryetarit të Kuvendit.

Në seancën plenare të datës 25 janar 2018 nuk u arrit shumica prej dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Për rrjedhojë Kuvendi i Shqipërisë me vendimet nr. 4/2018 dhe nr. 5/2018 të datës 25.01.2018 vendosi rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që rezultuan nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në datën 22.01.2018.

Bazuar në parashikimet e nenin 147, pika 8, të nenit 149, pika 8 të Kushtetutës dhe në pikën 16 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në datën 29.01.2018 Nënkomisioni zhvilloi mbledhjen e radhës për miratimin e listës së re të kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mori minimumin prej 4 votash, të nevojshme për t’u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni. Për rrjedhojë lista e dytë e kandidatëve për anëtar të KLGJ-së dhe KLP-së u përzgjodh nëpërmjet procedurës së shortit.

Në seancën plenare të 01.02.2018 nuk u arrit shumica prej dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Për rrjedhojë Kuvendi i Shqipërisë me vendimet nr. 11/2018 dhe nr. 12/2018 të datës 01.02.2018 vendosi rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që rezultuan nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në datën 29.01.2018.

Në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore mbledhja e radhës së Nënkomisionit për miratimin e listës së re (raundi i tretë) të kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor u zhvillua në datën 05.02.2018. Pas miratimit të listës së kandidatëve për votim u procedua me votimin e kandidatëve. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mori minimumin prej 4 votash, të nevojshme për t’u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit.

Për rrjedhojë përsëri procesi përfundoi në hedhjen e shortit. Pas përfundimit të të gjithë procesit të



votimit dhe shortit Nënkomisioni miratoi listën përfundimtare me 5 kandidatë jogjyqtarë dhe joprokurorë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë që rezultuan nga procedura e shortit dhe vendosi përcjelljen e listave Kryetarit të Kuvendit.

Me vendimin nr. 18/2018 Kuvendi i Shqipërisë vendosi të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Me vendimin nr. 19/2018 Kuvendi i Shqipërisë vendosi të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

2. KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Kuvendi i Shqipërisë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore ka organizuar dy herë procedurat e hedhjes së shortit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 149/d dhe pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 221 dhe 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe vendimit nr. 3, datë 24 janar 2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” nën drejtimin e Kryetarit i Kuvendit ***në datë 27 janar 2017*** u zhvillua hedhja e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet i janë përcjellë zyrtarisht Kuvendit të Shqipërisë nga institucionet përkatëse dhe janë bërë publike edhe në faqen zyrtare të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit njoftoi zyrtarisht për datën dhe orën e organizimit të shortit kryetarit e Gjykatës Kushtetuese, kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatin e Popullit, i cili merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit.

Në kuadër të transparencës, në procedurën e hedhjes së shortit u ftuan të merrnin pjesë përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare. Në përfundim të hedhjes së shortit Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit shpalli emrat e 9 anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të përzgjedhur nga shorti dhe emrat e anëtarëve zëvendësues.

I gjithë procesi u regjistrua në audio dhe video. Kuvendi i Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, publikoi në faqen zyrtare të internetit relacionin përkatës për procesin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në datë 7 dhjetor 2017, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d, pikës 11 të nenit 179 dhe nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë iu drejtua Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë me shkresë nr. 2668 prot., datë 10.11.2017, ku e njoftoi për pamundësinë e ushtrimit e kompetencës së tij kushtetuese për organizimin e procedurës së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.



Kryetari i Kuvendit, me qëllim zbatimin e detyrimit dhe të kompetencës kushtetuese për hedhjen e shortit për krijimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nisi procedurat për organizimin e shortit në përputhje me afatet kushtetuese dhe ligjore.

Në datën 20.11.2017 Kryetari i Kuvendit i është drejtuar me shkresë zyrtare kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për paraqitjen e listave të kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në zbatim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, Kryetari i Kuvendit njoftoi zyrtarisht institucionet përkatëse për datën dhe orën e organizimit të shortit si dhe Avokatin e Popullit, i cili sipas Kushtetutës dhe ligjit merr pjesë si vëzhgues. Në kuadër të transparencës, në procedurën e hedhjes së shortit u ftuan të merrnin pjesë përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare.

Nën drejtimin e zëvendëskryetares së Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në autorizimin nr. 2927/17 prot., datë 23.11.2017, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit sipas rregullave të përcaktuara në urdhrin nr.1, datë 22 nëntor 2017 të Kryetarit të Kuvendit.

Në përfundim të hedhjes së shortit zëvendëskryetarja e Kuvendit shpalli emrat e 9 anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga të cilët: 2 anëtarë nga Gjykata Kushtetuese, 1 anëtar nga Gjykata e Lartë, 1 anëtar nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 anëtarë nga zyrat e prokurorive pranë gjykatave të apelit, 2 anëtarë nga Gjykata e Apelit, 1 anëtar nga Gjykata Administrative.

Njëkohësisht në këtë procedurë shorti u zgjodhën dhe 3 anëtarët zëvendësues të KED-së, ku për secilin institucion të parashikuar në ligj u zgjodh një anëtar zëvendësues.

I gjithë procesi u regjistrua në audio dhe video. Kuvendi i Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, publikoi në faqen zyrtare të internetit relacionin përkatës për procesin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. NGRITJA E INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Amendimet kushtetuese të miratuara unanimisht me 140 vota pro në datën 22 korrik 2016 nëpërmjet ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 28.11.1998, «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar”, kanë parashikuar ngritjen e institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerët Publikë.

Me arritjen e marrëveshjes politike më datën 17 maj 2017, iu hap rruga proceseve të implementimit të një sërë ligjesh themelore të reformës në drejtësi dhe konkretisht krijimit të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë kuptim nisën një sërë procesesh të rëndësishme parlamentare lidhur me funksionin zgjedhës të Kuvendit sa i përket realizimit të procesit të shqyrtimit, përzgjedhjes dhe miratimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.



Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar në Kuvendin e Shqipërisë

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datë 3.03.2017 Avokati i Popullit i përcolli Kuvendit dosjet e kandidatëve që kishin shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit, së bashku me rekomandimet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Kuvendi bazuar në Kodin e Procedurave Administrative miratoi vendimet e mëposhtme:

- vendimin nr. 14/2017, datë 6.03.2017 “*Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit*”;

- vendimin nr. 18/2017, datë 16.03.2017 “*Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim dokumentacioni*”. Ky vendim parashikon kthimin e dosjeve vetëm për kandidatët që kishin depozituar dosje, duke shfuqizuar kështu vendimin nr. 14/2017 të Kuvendit, i cili kërkonte edhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e interesit për aplikues të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.

Bazuar në vendimin nr. 18/2017 të Kuvendit dhe në ligjin nr. 84/2016, në datën 7.04.2017 Avokati i Popullit i përcolli Kuvendit listën e kandidatëve që i plotësonin kriteret formale (84 veta), listën e kandidatëve që nuk i plotësonin kriteret formale (109 veta), listën e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për institucionet e rivlerësimit si dhe dosjet e secilit kandidat.

Ngritja e komisioneve parlamentare ad hoc për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve

Kuvendi i Shqipërisë ***në seancën plenare të datës 11.04.2017*** miratoi dy vendime:

- vendimin nr. 40/2017, datë 11.04.2017 “*Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve ad hoc dhe realizimin e procesit të votimit sipas ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”;

- vendimin nr.41/2017, datë 11.04.2017 “*Për krijimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Verifikimin e Kandidatëve për Institucionet e Rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”.

Me vendimin nr. 41/2017 u zgjodhën në përbërje të Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Verifikimin e Kandidatëve tre deputetë të caktuar nga grupet parlamentare të shumicës parlamentare. Nga opozita parlamentare nuk u paraqitën propozime.

Në seancën e posaçme plenare të datës 18.04.2017, në përmbushje të afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, Kuvendi miratoi me 82 vota pro ngritjen e dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes, në zbatim të ligjit 84/2016, përkatësisht me dy vendime:

- vendimin nr. 45/2017 “*Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit Ad Hoc me 12 anëtarë të Përzgjedhjes së Kandidatëve për Institucionet e Rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016*”;

- vendimin nr. 46/2017 “*Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit Ad Hoc me 6 anëtarë të Përzgjedhjes së Kandidatëve për Institucionet e Rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016*”.

Në Komisionin Ad Hoc me 12 anëtarë të Përzgjedhjes së Kandidatëve për Institucionet e Rivlerësimit Kuvendi miratoi 6 anëtarë të shumicës parlamentare. Ndërkohë mbetën pa u zgjedhur 6 anëtarët që duhej të vinin nga opozita, e cila nuk paraqiti asnjë emër.

Në këtë Komision Ad Hoc me 6 anëtarë Kuvendi miratoi tre anëtarë të shumicës parlamentare. Ndërkohë mungonin tre anëtarët që duhej të vinin nga opozita, pasi kjo e fundit nuk paraqiti asnjë emër.



Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe në Rregulloren e Kuvendit, u mbledh në sesion të jashtëzakonshëm **në datën 22 maj 2017** dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016 miratoi vendimet për përfaqësimin e pakicës parlamentare në Komisionin *Ad Hoc* të Verifikimit dhe në dy komisionet *ad hoc* të përzgjedhjes si më poshtë:

- vendimin nr. 72/2017, datë 22 maj 2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 41/2017 «Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *Ad Hoc* për Verifikimin e Kandidatëve për Institucionet e Rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’»”;

- vendimin nr. 73/2017 datë 22 maj 2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 45/2017 «Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *Ad Hoc* me 12 anëtarë të Përzgjedhjes së Kandidatëve, sipas ligjit 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’»”.

- vendimin nr. 74/2017 datë 22 maj 2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 46/2017 «Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *Ad Hoc* me 6 anëtarë të Përzgjedhjes së Kandidatëve, sipas ligjit 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’»”.

- vendimin nr. 75/2017 “Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 44/2017 «Për caktimin e deputetëve Silva Caka dhe Dashamir Peza anëtarë zëvendësues në komisionin parlamentar *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’»”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 41/2017”.

Veprimtaria e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për Verifikimin e Kandidatëve

Pas zhvillimit të seancave dëgjimore, në datën 31 maj 2017 komisioni u mbledh për të diskutuar listën për votim, e cila do t’u përcillej dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes. Komisioni zhvilloi procesin e votimit të listës së kandidatëve dhe brenda afatit 10-ditor e përcolli listën për votim me 68 kandidatë të dy komisionet parlamentare *ad hoc* të përzgjedhjes. Me përcjelljen e listës për votim dy komisioneve parlamentare *ad hoc* të përzgjedhjes ky komision e përmbylli aktivitetin e tij.

Veprimtaria e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të Përzgjedhjes me 6 anëtarë

Në përfundim të seancës dëgjimore me 34 kandidatët e listës për votim që konkurronin për gjyqtarë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit komisioni zhvilloi procesin e votimit për përzgjedhjen e shtatë gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe dy kandidatëve zëvendësues.

Veprimtaria e Komisioni Parlamentar *Ad Hoc* të Përzgjedhjes me 12 anëtarë

Në mbledhjen e datës 6 qershor 2017 u zhvillua seanca dëgjimore me 61 kandidatët e listës për votim që konkurronin për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe për komisionerë publikë. Në përfundim të seancave dëgjimore komisioni zhvilloi procesin e votimit për përzgjedhjen e 12 kandidatëve për komisionerë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, dy kandidatë zëvendësues për pozicionin e komisionerëve pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dy kandidatët për komisionerë publikë si dhe dy kandidatët zëvendësues për komisionerë publikë.

Komisioni u mbledh në datën 15 qershor 2017 për të zhvilluar procesin e votimit, por për shkak të mungesës së një anëtari për arsye shëndetësore kryetari i Komisionit iu drejtua Kryetarit të Kuvendit



për caktimin e një anëtari tjetër në vend të tij. Kuvendi, i mbledhur në sesion të jashtëzakonshëm, me vendimin nr. 80/2017, datë 17 qershor 2017 caktoi anëtarin zëvendësues të Komisionit *Ad Hoc*.

Komisioni me 12 anëtarë zhvilloi procesin e votimit në datën 17 qershor 2017. Komisioni zhvilloi fillimisht procesin e votimit për përzgjedhjen e 12 kandidatëve për komisionerë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nga lista e kandidatëve për votim. Më tej përzgjodhi dy kandidatët zëvendësues për pozicionin e komisionerëve pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në mbyllje të këtij procesi Komisioni hartoi listën e kandidatëve për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe komisionerët publikë.

Kuvendi i Shqipërisë në seancën e dytë plenare, datë 17 qershor, me 100 vota “pro”, 2 vota “kundër” dhe 5 abstenime miratoi vendimin nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 «Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë»”. Ky vendim është botuar në “Fletoren zyrtare” nr. 133, datë 19 qershor 2017.

Pas ngritjes së organeve të rivlerësimit kalimtar Kuvendi ndërmori hapat e mëtejshëm për fillimin e funksionimit të këtyre organeve në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji i tyre organik nr. 84/2016. Pas paraqitjes së propozimeve nga organet e rivlerësimit kalimtar, përkatësisht të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, komisionerëve publikë dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e strukturave organizative dhe klasifikimin e pagave për personelin e tyre dhe iniciimin e legjislaturës së re në shtator 2017, komisioni përgjegjës për çështjet ligjore përfshiu në programin e tij të punës me prioritetin më të lartë propozimet e paraqitura. Lidhur me këto propozime Komisioni organizoi edhe konsultime të përbashkëta me përfaqësuesit e organeve të rivlerësimit dhe institucionet shtetërore përgjegjëse në fushat përkatëse.

Në datën 25 shtator Komisioni miratoi strukturat organizative dhe klasifikimin e pagave të tri organeve të rivlerësimit kalimtar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 si dhe të legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre institucioneve dhe forcimin e komponenteve të tyre thelbësore duke:

- parashikuar zbatimin e menjëhershëm të sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të parashikuara në legjislacionin e ri për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sistem ky që për magjistratët e tjerë parashikohet të fillojë të zbatohet nga janari 2019;

- u garantuar organeve të rivlerësimit kalimtar mbrojtje të veçantë në përputhje me ligjin e tyre organik;

- unifikuar standardet e parashikuara për këto struktura në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Në respektim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në ligjin për buxhetin e vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë miratoi buxhetin përkatës për tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Kapitulli 6

DIPLOMECIA PARLAMENTARE

Gjatë vitit 2017 në fokus të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë ka qenë forcimi dhe aktivizimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, vendet e rajonit dhe vendet me të cilat Shqipëria ka interesa strategjike. Megjithëse një vit elektoral, gjatë vitit 2017 janë realizuar një sërë veprimtarish në kuadër të marrëdhënieve me jashtë, që kishin si objektiv:

- intensifikimin e punës në nivel parlamentar për avancimin në axhendën europiane të Shqipërisë;
- intensifikimin e kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;
- forcimin e bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.

Në mënyrë të përmbledhur aktiviteti ndërkombëtar gjatë periudhës janar–dhjetor 2017 përfshin:

- **2** vizita të kryeparlamentarëve të vendeve të huaja në Shqipëri;
- **5** vizita të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë jashtë vendit me ftesë të homologëve e tij;
- **87** takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete nga vende të ndryshme, si presidentë, kryeministra, ministra të Punëve të Jashtme, ambasadorë etj.;
- **23** takime të nënkryetarëve të Kuvendit me personalitete të ndryshme;
- **80** takime të kryetarëve të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë, kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetarëve të grupeve të miqësisë dhe deputetëve me personalitete të ndryshme ndërkombëtare;
- **1** pjesëmarrje e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme si dhe 5 pjesëmarrje të nënkryetarëve;
- **3** aktivitete shumëpalëshe të organizuara në Kuvendin e Shqipërisë;
- **85** pjesëmarrje të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare si dhe pjesëmarrje në aktivitete dhe seminare të deputetëve dhe stafit të administratës së Kuvendit të Shqipërisë.

Aktivitete në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe

I. a. Aktivitete të Kryetarit të Kuvendit jashtë vendit

Në funksion të intensifikimit të bashkëpunimit me parlamentet e vendeve të tjera si dhe nxitjes së diplomacisë parlamentare, shkëmbimet në nivel dypalësh kanë qenë mjaft aktive dhe të kënaqshme.

• *Në janar 2017 Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë në SHBA, i ftuar në ceremoninë zyrtare të marrjes së detyrës nga Presidenti i SHBA-ve Donald Trump.* Gjatë kësaj vizite në Uashington D.C Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime me personalitete të ndryshme të Kongresit të SHBA-ve, ku u vlerësua rëndësia e miratimit të reformës në drejtësi si dhe u konfirmua mbështetja e administratës së re amerikane për implementimin përfundimtar të kësaj reforme. Kryetari i Kuvendit dha sigurinë për qëndrimin e palëkundur të Shqipërisë në përballjen e sfidave të përbashkëta dhe përmbushjen e



detyrimeve të saj në partneritetin strategjik që ajo ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

• **Në shkurt 2017 Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë pune në Vjenë.** Qëllimi i kësaj vizite ishte intensifikimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe mbështetja e Austrisë në proceset integruese të Shqipërisë.

• **Në mars 2017 Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë zyrtare në Helsinki (Finlandë).** Gjatë takimit me kryeparlamentaren e Finlandës, znj. Maria Lohela, Kryetari i Kuvendit vlerësoi mbështetjen e Finlandës në integrimin europian të Shqipërisë dhe shprehu angazhimin për t'i çuar marrëdhëniet mes dy parlamenteve në një nivel më të lartë. Zoti Meta e vuri theksin te rëndësia e avancimit me zbatimin e reformës kyçe të sistemit të drejtësisë. Ndërsa Kryetarja e parlamentit të Finlandës, znj. Maria Lohela, theksoi se mes dy vendeve ka hapësira të shumta për bashkëpunim, sidomos në fushën e biznesit, por edhe në fushën e politikës dhe atë të turizmit.

• **Në nëntor 2017, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Prishtinë.** Kryetari i Kuvendit u prit nga homologu i tij, z. Vaseli, i cili shprehu kënaqësinë e veçantë që kishte nderin të mikpriste delegacionin e Kuvendit të Shqipërisë të kryesuar nga zoti Ruçi. Gjithashtu ai shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e palëkundur dhe të vazhdueshme që Shqipëria dhe të gjitha institucionet shqiptare i kanë dhënë Kosovës. Në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve ndërparlamentare u propozua ngritja e një komiteti të përbashkët sipas formatit të komiteteve të përbashkëta që dy vendet kanë me PE-në, në fokus të punës të të cilit të jetë zgjidhja e problemeve legjislative dhe lehtësimi i pengesave të studentëve shqiptarë në Kosovë dhe të studentëve të Kosovës në universitetet shqiptare, por dhe çështje të tjera, si: regjimet doganore, lejet e qëndrimit etj.

• **Gjatë vizitës së tij në Prishtinë Kryetari i Kuvendit u prit në një takim edhe nga Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe nga Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj.** Presidenti i Republikës së Kosovës e nderoi Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë me Urdhrin e Lirisë me motivacionin: “Për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”.

• **Në dhjetor 2017 në Uashington DC (SHBA) u zhvillua Forumi i 10-të Parlamentar i Sigurisë dhe Inteligjencës,** në të cilin mori pjesë një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë, i kryesuar Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi. Gjatë ditëve të qëndrimit në Uashington zoti Ruçi zhvilloi takime të veçanta me kryetarin e Nënkomisionit për Terrorizmin dhe Financimin e Paligjshëm, z. Robert Pittenger, senatorin Gary Peters, bashkëkryetar i Grupit të Shqipërisë në Senat, kongresmenët Steve King, Robert Aderholt dhe Eliot Engel etj.

I. b. Takime të Kryetarit të Kuvendit në Tiranë

Gjatë vitit 2017 Kuvendin e Shqipërisë e kanë vizituar:

- Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta; Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferri, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

Gjatë vizitave të kryeparlamentarëve nga Kosova dhe Maqedonia u diskutua forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe intensifikimi i mëtejshëm i tyre.

II. a. Aktivitete dypalëshe në kuadër të komisioneve parlamentare dhe grupeve të miqësisë

Shkëmbimet e vizitave dypalëshe në kuadër të delegacioneve nga komisionet parlamentare kanë pasur në fokus intensifikimin e marrëdhënieve me vendet e rajonit dhe vendet anëtare të BE-së. Në këtë kuadër janë zhvilluar vizita të delegacioneve nga komisionet parlamentare dhe një vizitë e Grupit Parlamentar të Miqësisë Gjermani–Shqipëri, konkretisht:

- **9–10 shkurt 2017:** vizitë zyrtare e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuar nga kryetari komisionit, z. Elmi Reçiça;



- **20–22 shkurt 2017:** vizita e delegacionit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuar nga kryetarja e komisionit, znj. Lirie Kajtazi;

- **14–16 mars 2017:** vizita e delegacionit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës dhe për Inteligjencën të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuar nga kryetari komisionit, z. Haxhi Shala;

- **8–9 shkurt 2017:** vizitë zyrtare në Mal të Zi e një delegacioni nga Komisioni për Politikën e Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë, i përbërë nga znj. Arta Dade (kryetare e Komisionit), z. Aldo Bumçi (anëtar), znj. Luljeta Arapi (anëtare), znj. Edlira Çekrezi (anëtare);

- **20–21 shkurt 2017:** në Prishtinë u zhvillua takimi i kryetarëve të komisioneve për politikën e jashtme të vendeve të Europës dhe Ballkanit me temë: “E ardhmja e Ballkanit në Europë dhe integrimet euroatlantike”. Në këtë aktivitet mori pjesë znj. Arta Dade, kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë;

- **14–17 janar 2017:** me ftesë të parlamentit të Izraelit (Knesset) një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë, i përbërë nga znj. Valentina Leskaj (kryetare e Grupit të Miqësisë Shqipëri–Izrael), z. Anastas Angjeli (deputet), z. Eduard Selami (deputet), znj. Silva Caka (deputete), zhvilloi një vizitë zyrtare në Izrael;

- **28 qershor–9 korrik:** deputeti Fatmir Toçi, në cilësinë e kryetarit të grupeve të miqësisë Shqipëri–Slloveni dhe Shqipëri–Zvicër, organizoi disa takime me homologë në këto shtete;

- **17 tetor 2017:** vizitë në Kuvendin e Shqipërisë të përfaqësuesve të Bundestagut gjerman. Gjatë kësaj vizite u zhvilluan takime me Kryetarin e Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, dhe përfaqësues të Grupit të Miqësisë Shqipëri–Gjermani.

Aktivitete në kuadër të organizatave shumëpalëshe

Gjatë vitit 2017 delegacione të nivelit të lartë të kryesuar nga Kryetari apo nënkryetarët e Kuvendit të Shqipërisë kanë marrë pjesë në një sërë veprimtarish shumëpalëshe, konkretisht:

- Në datën **27 tetor 2017** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, mori pjesë në punimet e Konferencës së 8-të të Kryetarëve të Parlaenteve të Ballkanit Perëndimor, organizuar me iniciativën e Kryetarit të parlamentit të Hungarisë, z. László Kóvér. Dy temat në të cilat u fokusuan punimet e konferencës ishin: “Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE: rezultatet dhe aspiratat” dhe “Dimensioni i sigurisë së bashkëpunimit të Ballkanit Perëndimor: kontribut në stabilitetin e Europës”.

- Në datat **1–2 mars 2017** në Gjenevë (Zvicër) u mbajt samiti ndërkombëtar “*Women in Public Service and Women @the Table*”, ku mori pjesë znj. Valentina Leskaj (nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë).

- Në datën **2 prill 2017** nënkryetarja e Kuvendit, znj. Valentina Leskaj, dhe deputeti Fatmir Toçi ishin të ftuar në ceremoninë e hapjes së takimit vjetor të Rrjetit Europian të Komiteteve Kombëtare të Helsinkit në Selanik.

- Në datat **17–18 maj 2017** në Varshavë u zhvillua takimi i kryetarëve të parlaenteve të Europës Qendrore dhe Lindore. Nga Kuvendi i Shqipërisë morën pjesë znj. Leskaj, nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë, dhe deputeti Namik Kopliku.

- Në datat **26–28 nëntor 2017** në Bratislavë (Sllovakia) u zhvillua një aktivitet rajonal mbi transparencën dhe bashkëpunimin parlamentar me shoqërinë civile. Nga Kuvendi i Shqipërisë morën pjesë znj. Vasilika Hysi, nënkryetare e Kuvendit, dhe deputetja Rudina Hajdari.

- Në datat **21–22 nëntor 2017** në Rabat u zhvillua mbledhja e Rrjetit Parlamentar për Luftën kundër HIV-SIDA-it, Tuberkulozit dhe Malariaes të APF-së. Nga Kuvendi i Shqipërisë morën pjesë znj. Vasilika Hysi dhe znj. Ermonela Valikaj (Felaj).

Gjithashtu Kuvendi i Shqipërisë ka qenë organizator ose bashkorganizator i disa aktivitete në kuadër



të bashkëpunimit të organizatave shumëpalëshe dhe bashkëpunimit rajonal.

Në bashkëpunim me Asambleshën Parlamentare të Këshillit të Europës janë organizuar këto aktivitete:

- **24 shkurt 2017:** seminar parlamentar për lirinë e fjalës në medie;
- **25 tetor 2017:** aktiviteti i Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë me temë “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Europën Juglindore”;
- **24 nëntor 2017:** seminar kombëtar, organizuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë me temë “Lufta kundër intolerancës, diskriminimit dhe urrejtjes”.

Ndërsa në kuadër të bashkëpunimit si vend anëtar i PABSEC-ut më **19–20 tetor 2017** nën kujdesin e Kuvendit të Shqipërisë u organizua takimi i 49-të i Komisionit të Çështjeve Ekonomike, Tregtare, Teknologjike dhe Mjedisore të PABSEC-ut.

Delegacionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare kanë marrë pjesë në sesionet parlamentare dhe në mbledhjet e komisioneve të përhershme të organizatave ku vendi ynë është anëtar, si NATO, OSCE, PE, APKiE, SEEC, PABSEC, PAM, NAJ, IPU, CEI, AP Ortodoksisë etj.

Gjithashtu gjatë vitit deputetë dhe përfaqësues të administratës së Kuvendit të Shqipërisë kanë marrë pjesë në disa aktivitete, konferenca apo seminare të zhvilluara nga Njësia e Përafrimit pranë Parlamentit Europian me tema nga më të ndryshmet, si: *Trans-European Networks Policy and Connectivity Agenda*; “Procesi i integritetit evropian i Ballkanit Perëndimor”; *Public Procurement and Parliament’s role*; *Women’s Economic Empowerment*.



Kapitulli 7

TRANSPARENCA PARLAMENTARE

Komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm publik, duke shtuar transparencën dhe aksesin në punimet e organeve parlamentare, është në përmbushje të misionit të Kuvendit të Shqipërisë për të qenë i përgjegjshëm, i aksesueshëm dhe efikas.

Në përmbushje të këtij misioni, gjatë vitit 2017 Kuvendi i Shqipërisë ka fuqizuar më tej transparencën parlamentare përmes krijimit të kushteve të duhura për marrëdhëniet dhe ndërveprimin gjithnjë e më të ngushtë me qytetarët, ndërtimin e marrëdhënieve funksionale me publikun si dhe intensifikimin e punës në drejtim të rritjes së perceptimit publik për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin.

Një hap i rëndësishëm në drejtim të forcimit të mëtejshëm i transparencës parlamentare është miratimi i *Strategjisë së komunikimit të Kuvendit 2018–2021* nga Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 112, datë 4.05.2017. *Strategjia e komunikimit* është konceptuar si një skaletë e bazuar në arritjet e deritanishme për transparencën parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë dhe është përqendruar në veprimtaritë kryesore të komunikimit me publikun në vijueshmëri. Ky dokument shoqërohet me një plan veprimi të strukturuar, me iniciativa konkrete në përmbushje të vizionit, misionit dhe objektivave që ai përmban. *Strategjia e komunikimit të Kuvendit* është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe është mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë.

❖ Parlamenti dhe publiku

Gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë hapa konkretë për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe Kuvendit si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë civile për rolin e dobishëm që ka në procesin vendimmarrës. Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile vëmë në dukje se me kujdesin e veçantë të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, në sallën e seancave plenare u mbajt sesiioni përmbyllës i Parlamentit të Parë Rural Shqiptar, i cili zhvilloi punimet në datat 28–30 shtator në Tiranë.

Në kuadër të bashkërendimit të punës me universitetet dhe drejtoritë mësimore për zbatimin e programeve që kanë për qëllim njohjen e studentëve dhe të nxënësve me veprimtarinë e Kuvendit, janë zbatuar projekte të ndryshme, edhe në bashkëpunim me OSBE-në, për organizimin dhe krijimin e urave lidhëse midis qytetarëve me Kuvendin, *Building a bridge between parliament and civil society*. Këto takime informuese nëpër rrethet e Shqipërisë janë përmbyllur me simulimin e seancave plenare nga të rinjtë në sallën e seancave plenare me praninë edhe të deputetëve.

Kuvendi i Shqipërisë ka vijuar edhe gjatë vitit 2017 traditën e organizimit të aktivitetit “Dyert e hapura”. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit më 9 maj 2017 në kuadër të Ditës së Europës dhe me rastin e festave të 28 dhe 29 Nëntorit. Në këto aktivitete u shënu



edhe pjesëmarrja më e lartë e vizitorëve në Kuvendin e Shqipërisë. Vihet re interesi në rritje i moshave të reja për marrjen e njohurive mbi Kuvendin e Shqipërisë. Interesi në rritje i të rinjve për funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë vihet re edhe nga vizitat e realizuara gjatë vitit 2017 nga shkolla, universitetet dhe grupe të organizuara studentore nga qytete të ndryshme të vendit, por dhe nga Kosova e shtete të tjera. ***Për vitin 2017 numri i vizitorëve arrin në 7000 persona, kundrejt 6454 në vitin 2016.***

Në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut ka vijuar me rigozitet ***përditësimi i programit të transparencës i Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”***. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës institucioni ynë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij. Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparente veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë përmes paraqitjes së detajuar të tij dhe lehtësisht të kuptueshme në faqen zyrtare www.parlament.al si dhe në mjediset e institucionit. Ky program është ndërtuar në mënyrë të tillë që mundëson dhënien e informacionit për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, gjatë vitit 2017 janë proceduar 55 kërkesa për informacion, duke iu përgjigjur kërkesit brenda afateve të parashikuara në këtë ligj.

Në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2017 janë dorëzuar 16 peticione, 9 prej të cilave janë dërguar nga qytetarë dhe 7 nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe grupe të interesit në vend. Këto peticione janë trajtuar bazuar në nenin 104 të Rregullores së Kuvendit.

Në kuadër të transparencës parlamentare dhe aksesit të publikut në dokumentet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2017 janë realizuar një sërë publikimesh, si “Punimet e Kuvendit”, që përmban procesverbale të seancave plenare në vitin 2015; “Fjalime të personaliteteve ndërkombëtare në Kuvendin e Shqipërisë”, që pasqyron fjalimet e plota të mbajtura përpara deputetëve shqiptarë nga personalitetet e huaja që kanë vizituar zyrtarisht Shqipërinë gjatë periudhës 1991–2016. Ka vijuar gjithashtu publikimi i revistës “Kuvendi” me dy numrat e përvitshëm të saj.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit me botën akademike dhe qasjen e publikut tek informacioni parlamentar, janë intensifikuar procedurat e hapjes së Bibliotekës së Kuvendit për qytetarët. Biblioteka e Kuvendit disponon në fondin e saj 18354 volume libra dhe 14025 tituj (9725 tituj në gjuhën shqipe dhe 4300 tituj në gjuhë të huaj).

❖ Parlamenti dhe media

Ndërveprimi me medien për garantimin e transparencës parlamentare ndaj publikut edhe gjatë vitit 2017 është bazuar në parimin e transparencës, objektivitetit dhe paanshmërisë. Në përmbushje të këtij synimi ***Kuvendi e ka mbështetur aktivitetin e tij në pasqyrimin e axhendës së aktiviteteve parlamentare në kohë dhe me saktësi, duke ruajtur marrëdhëniet cilësore dhe profesionale të bashkëpunimit me shërbimet e tjera të Kuvendit.***

Gjatë vitit 2017 në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në medie është pasqyruar informacioni mbi procesin e reformës në drejtësi si dhe për përzgjedhjen e organeve të reja në kuadër të këtij procesi të rëndësishëm dhe unik për vendin. Gjatë muajve korrik–shtator 2017, në prag të fillimit të Legjislaturës IX parlamentare, faqja zyrtare e Kuvendit erdhi e përditësuar me informacionet që i takojnë legjislaturës së re, duke ruajtur dhe arkivuar gjithë informacionin përkatës. Në funksion të transparencës parlamentare, veprimtaria e komisioneve parlamentare dhe organeve të tjera të Kuvendit si dhe seancat



plenare janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit www.parlament.al përmes njoftimeve për shtyp dhe fotove ilustruese

Të dhënat e një analize krahasuese për këtë periudhë dëshmojnë se nga shërbimet e Kuvendit janë ndjekur, janë pasqyruar në faqen e internetit dhe janë komunikuar në medie 1321 mbledhje të komisioneve parlamentare dhe seanca plenare, çka tregon se ka rritje në krahasim me vitet e mëparshme, duke marrë këtu parasysh se 2017-a ishte një vit elektorale. Materialet e publikuara online janë përkthyer në kohë reale në gjuhën angleze dhe gjenden të publikuara në seksionin anglisht po në faqen zyrtare të internetit.

Edhe gjatë vitit 2017 janë përditësuar të dhënat mbi akreditimin e përfaqësuesve të medias pranë Kuvendit të Shqipërisë. *Numri i akreditimeve pranë Kuvendit të Shqipërisë është rreth 1170 përfaqësues të medieve.* Në këtë numër përfshihen dhe stafet teknike të medieve, nisur nga fakti se transmetimet direkte të veprimtarisë së Kuvendit, jo vetëm në seancë plenare, gjatë vitit 2017 kanë qenë në rritje.

Po ashtu në kuadër të transparencës së veprimtarisë parlamentare gjatë vitit 2017 vijoi *publikimi në kohë dhe saktë i procesverbaleve të seancave plenare, të komisioneve parlamentare, por dhe punimet e organeve të Kuvendit. Gjatë vitit 2017 janë zbardhur dhe redaktuar 45 seanca plenare, me një shtrirje kohore prej 11 115 minutash, të cilat janë pasqyruar në 1453 faqe. Gjithashtu janë zbardhur dhe redaktuar 388 mbledhje komisionesh, me një shtrirje kohore prej 30 970 minutash, që janë pasqyruar në 10536 faqe.*

❖ **Forcimi i transparencës parlamentare përmes teknologjisë së informacionit**

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) krijon kushtet e duhura për marrëdhëniet dhe ndërveprimin gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Në këndvështrimin e drejtuesve të Kuvendit të Shqipërisë, objektiv i synuar gjatë 2017, por edhe në vitet në vijim, mbetet maksimizimi i komunikimit efektiv përmes një sërë instrumentesh, të cilat mund të përdoren për ndërtimin e marrëdhënieve funksionale me publikun.

Një arritje në kuadër të implementimit të sistemeve të reja gjatë vitit 2017 ishte aplikimi me sukses nga Kuvendi i një sistemi të ri elektronik votimi në zbatim të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në procesin e përzgjedhjes së këtyre organeve.

Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kuvendin e Shqipërisë është një ndër hapat dhe aktivitetet konkrete të parashikuara edhe në “Strategjinë e komunikimit të Kuvendit”, miratuar nga Byroja e Kuvendit në datën 4 maj 2017. Sa më sipër, forcimi i transparencës parlamentare përmes zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mbetet edhe në vijim një objektiv i synuar.



Kapitulli 8

ADMINISTRIMI

I. FINANCA DHE BUXHETI

Planifikimi i nevojave buxhetore

Në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Kuvendi koordinoi punën për përgatitjen e dokumentit të projektbuxhetit afatmesëm në të dyja fazat që parashikon kuadri ligjor, duke përcjellë brenda afatit ligjor në Ministrinë e Financave projektbuxhetin e konsoliduar, formatet e kërkesave shtesë, relacionin përkatës dhe regjistrin e riskut.

Në zbatim të neneve 10 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit, projektbuxheti, i shoqëruar me analizën dhe argumentet përkatëse, iu bë me dije paraprakisht Sekretariatit për Buxhetin dhe Byrosë së Kuvendit.

Gjatë vitit 2017, për shkak të fillimit të legjislaturës së re dhe nevojës së rishikimit të politikave të programeve, objektivave dhe aktiviteteve në funksion të tyre, është ngritur një grup pune, që ka ndjekur procesin e rivlerësimit të kërkesave buxhetore për vitin 2018 gjatë periudhës tetor–nëntor 2017. Përmbledhja e këtij procesi i është kaluar Sekretariatit për Buxhetin dhe Komisionit të Ekonomisë për vendimmarrje dhe reflektim në buxhetin e vitit 2018.

Gjatë punës për përgatitjen e projektbuxhetit është synuar rritja e efikasitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Kjo kërkon vendosjen e objektivave të qartë, të matshëm në terma sasiorë, përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike, afateve etj.

Realizimi i buxhetit të vitit 2017

Buxheti i Kuvendit është miratuar me ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe ka ndryshuar në muajin gusht 2017 në zërin e investimeve dhe me aktin normativ nr. 3, datë 06.11.2017 në zërin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale.


Për vitin 2017 rezulton se buxheti është realizuar në masën 84,93%, që sipas programeve dhe zërave buxhetorë paraqitet në tabelën e mëposhtme:



Në mln lekë

Zërat buxhetorë	Programi legjislativ		Programi administrativ		Buxheti total		% realizimit
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
a	1	2	3	4	5	6	7=6/5
Shpenzime për paga	332	301	197	196	529	497	93,95%
Shpenzime për kontribute të sigurimeve	47	36	33	31	80	67	83.75%
Shpenzime operative për funksionim	309	238	123	85	432	323	74,76%
Shpenzime kapitale	0	0	40	31	40	31	77,50%
	688	575	393	343	1081	918	84,92%

Realizimi plan–fakt i buxhetit të Kuvendit në vite paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore

Për vitin 2017 shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 92,61%, ndërsa sipas programeve buxhetore realizimi paraqitet në masën 98,69% për programin administrativ dhe 88,92% për programin legjislativ.

Mosrealizimi i fondit të pagave në programin administrativ vjen kryesisht si rezultat i vendeve vakante, që është në proces rekrutimi.


Mosrealizimi i fondit të pagave në programin legjislativ ka ardhur për këto arsye:

- 8 deputetë të legjislaturës së re kanë kaluar në funksionin e ministrit (shtator 2017);
- 7 këshilltarë të Kryetarit të Kuvendit që parashikon struktura, në periudhën shtator–dhjetor 2017 kanë qenë vende vakante;
- nga 24 nëpunës që parashikon struktura për zyrat zgjedhore, vetëm 10 punonjës janë rekrutuar dhe trajtuar me pagë.

Më poshtë jepet grafikisht fondi faktik i pagave në vite, i ndarë në fond për stafin politik dhe fond për stafin administrativ.



Shpenzimet faktike në paga (në mln lekë), të ndara në staf politik dhe staf administrativ




Më 1 mars 2017 hyri në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 202/2017, mbi bazën e të cilit u llogarit efekti financiar 10-mujor për vitin 2017 dhe efekti financiar vjetor për vitin 2018. Si rezultat e argumenteve të mësipërme dhe analizave të herëpashershme, pavarësisht efektit në rritje, nuk u kërkuan fonde buxhetore shtesë për vitin 2017.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Për vitin 2017 ky zë është realizuar në masën 74,76%, ndërsa sipas programeve ky realizim është përkatësisht 77% për programin legjislativ dhe 69,1% për programin administrativ.

Në këtë zë shpenzimesh përfshihet një gamë e gjerë shërbimesh dhe mallrash, që janë paraqitur sipas peshës specifike që zënë në totalin e shpenzimeve në grafikun e mëposhtëm:





- Grupi më i madh i shpenzimeve në këtë zë përfaqëson *përfitimet ligjore* që statusi i deputetit u njeh anëtarëve të parlamentit për të lehtësuar udhëtimet në qarqet elektorale dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve parlamentare, në seancat plenare dhe veprimtari të tjera parlamentare.


Këto shpenzime planifikohen mbi bazën e vendimit nr. 114/2014 të Kuvendit “Për trajtimin e deputetëve”.

Realizimi faktik i këtyre shpenzimeve është 80%, për shkak se numri i ditëve të shërbimeve të deklaruar nga deputetët është më i ulët se parashikimi; numri i mbledhjeve të komisioneve gjithashtu nuk arrin numrin e parashikuar, kontratat e qirave të paraqitura e të trajtuara financiarisht në vitin 2017 ishin 9.

- *Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit* janë realizuar në masën 68% të planifikimit. Janë disa faktorë që ndikojnë në realizimin e këtyre shpenzimeve, që kanë të bëjnë me numrin e aktiviteteve ndërparlamentare, kohën kur bëhet udhëtimi (që ndikon në çmimin e biletave), me numrin përbërës të delegacioneve, kohën e qëndrimit në aktivitete dhe së fundi duhet sjellë në vëmendje se viti 2017 ishte vit elektorale dhe për periudhën maj–shtator 2017 nuk ka pasur aktivitet parlamentar.

Gjatë vitit 2017 janë bërë rreth 95 udhëtime jashtë shtetit, në të cilat kanë udhëtuar 79 veta (staf politik dhe administrativ) dhe rreth 131 deputetë.

Paraqitja krahasuese e këtyre shpenzimeve në vite jepet në grafikun e mposhtëm:



Shpenzimet për dieta, akomodim dhe të tjera janë bërë konform vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për mirëmenaxhimin e këtyre shpenzimeve Byroja e Kuvendit ka miratuar rregulloren “Për udhëtimet ndërkombëtare”, ku janë parashikuar rregullat kur shpenzimet për jashtë shtetit mbulohen nga buxheti i shtetit, nga vetë punonjësi apo deputeti.

- *Shpenzimet për kuotat parlamentare* janë realizuar në masën 100%.




Nr.	Institucioni/organizata së cilës i akordohet transferta	Realizimi në vitin 2017
		në lekë
a	b	l
Shërbimi Legjislativ		
1	Atlantiku Verior (PAM)	1.465.900
2	OSBE	544.448
3	Unioni Ndërparlamentar (IPU)	1.444.800
4	PABSEC	8.501.912
5	Asambleja Parlamentare e Frankofonisë (AIPLE)	410.159
6	Grupi 12+ Shoqata e Sekretarëve të Përgjithshëm	108.032
7	NATO	431.824
8	Membership fee në Arkivat Ndërkombëtare	27.460
9	Federata Ndërkombëtare e Bibliotekave	65.355
Totali		12.999.890

• Shpenzimet për mirëmbajtje (mirëmbajtje e zyrave, autoveturave, sistemet elektronike e të tjera pajisje zyrash) zënë një peshë specifike të konsiderueshme në totalin e shpenzimeve të funksionimit. Realizimi faktik për vitin 2017 paraqitet në masën 74,8%. Arsyet e mospërdorimit 100% të fondit të planifikuar janë:

- afatet e procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës, periudhë në të cilën nuk merret shërbimi;

- si rezultat i konkurrencës në procedurat e prokurimit kontratat, ofertat fituese kanë qenë më të ulëta sesa fondi limit i planifikuar.






Shërbimet e mirëmbajtjes janë kryesisht shërbime të planifikuara, të cilat synojnë minimizimin e avarive, shtimin e jetëgjatësisë së pajisjeve dhe sistemeve dhe përdorimin sa më efikas të tyre, duke i orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese për mirëmbajtje dhe jo drejt shpenzimeve për riparime.

- *Shpenzime utilitare.* Janë realizuar në masën 74%. Kjo si rezultat i konsumit më të ulët të energjisë dhe ujit, por dhe të shpenzimeve telefonike. Gjithashtu gjatë vitit 2017 Kuvendi i Shqipërisë nuk ka nënshkruar kontrata me operatorë të telefonisë celulare, duke mos përdorur kështu fonde buxhetore për mbulimin e shpenzimeve telefonike për ata drejtues që përfitojnë nga buxheti i shtetit.

- *Shpenzime për pritjen e delegacioneve të huaja*

Realizimi i këtij grupi shpenzimesh për vitin 2017 rezulton në masën 41%.




Planifikimi këtyre shpenzimeve bëhet nga shërbimi përkatës duke pasur parasysh trendin e viteve të mëparshme dhe mbi një axhendë që nuk është plotësisht e konfirmuar. Viti 2017 ishte vit elektorale dhe për një periudhë tre-katërmujore nuk ka pasur fluks aktivitetesh pritëse.

Menaxhimi i këtyre shpenzimeve bëhet duke miratuar paraprakisht programin e vizitës, protokollin zyrtar, kuotat e përcaktuara në VKM për numrin dhe vlerat për person të shpenzimeve etj.

Është e rëndësishme të theksohet se kërkohet një rishikim i akteve nënligjore që përcaktojnë modalitetet e pritjeve, pasi u përkasin viteve 1995–1999.



shpenzime për karburant në lekë



- *Shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore*

Gjatë vitit 2017 janë ekzekutuar vendime gjyqësore ndaj kreditorëve ish-punonjës, ish-deputetë dhe ish-funksionarë që emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi.

Vlera e ekzekutuar në vitin 2017 është 23,4 milionë lekë, nga të cilat 1,4 milionë lekë janë shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore.

Përveç këtyre vendimeve në proces është kërkuar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nuk kanë filluar ende procedurat e ekzekutimit për 6 vendime të tjera gjyqësore. Këto vendime janë listuar dhe janë bërë pjesë e grafikut të ekzekutimit me fondet e vitit 2018.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është bazuar në udhëzimin nr. 1 të Kryeministrit, datë 4.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” si dhe udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Investimet kapitale

Gjatë vitit 2017 investimet janë realizuar në masën 76,01% sipas projekteve të paraqitura në tabelë:

EMËRTIMI I PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE	PLAN	FAKT	REALIZIMI
	40,659,007	30,906,779	76,01%
Projekt për investimin e mbrojtjes kundër zjarrit në sallën e seancave plenare	150,000	84,000	56,00%
Rikonstruksion në tarracën e godinës së sallës së seancave plenare	3,787,104	3,743,760	98,86%
Blerje pajisje për Kuvendin	10,507,903	7.671.781	73%
Blerje autoveture	10,550,000	9,424,440	89,33%
Projekti i rikonstruksionit të tarracës	264,000	264,000	100,00%
Sistem elektronik votimi për <i>vetting</i> -un	9,000,000	9,000,000	100,00%
TVSH, projekti “Audio-video” (IPA)	5,600,000	0	0,00%
Kënd informimi	800,000	718,719	89,84%




Realizimi në përqindje, që paraqitet në tabelë, paraqet raportin e realizimit të fondeve, të cilat për shkak të procedurave të konkurrimit janë më të ulëta se planifikimi, ndërsa projektet janë realizuar në masën 100%.

- *Procedurat e prokurimit*

Që në fillim të vitit buxhetor i gjithë buxheti detajohet, hartohen regjistrat e prokurimeve, ku përcaktohen procedurat që do të ndiqen për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe realizimin e projekteve të investimeve.

Numri i këtyre procedurave të realizuara gjatë vitit 2017 paraqitet në grafik:



Kontrolli i veprimtarisë financiare të Kuvendit

Në vitin 2017 një grup audituesish të Kontrollit të Lartë të Shtetit ushtroi kontroll në Kuvendin e Shqipërisë dhe finalizoi punën e tij me dërgimin e raportit përfundimtar dhe propozimet për përmirësime ligjore si dhe masat organizative me shkresën nr. 1224/6, datë 28.04.2017.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna u hartua plani i masave për plotësimin e tyre dhe iu bë me dije të gjithë drejtuesve të shërbimeve me shkresën nr. 1488, datë 18.05.2017.

Gjithashtu në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; raportit të auditimit nr. 1224/6 prot., datë 28.04.2017 të KLSH-së; planit të masave të programuar nga administrata e Kuvendit, me shkresën nr. 3651/6 prot., datë 17.05.2017 iu dërgua informacion brenda afateve ligjore Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me plotësimin e rekomandimeve.

Forcimi i kapaciteteve administrative

1. Hapja e zyrave në qarqe

Bazuar në vendimet e Byrosë së Kuvendit, përkatësisht nr. 19, datë 11.11.2014 “Për hapjen e zyrave për deputetët e Kuvendit në 12 qarqe” dhe nr. 22, datë 2.02.2015 “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e administratës së Kuvendit”, me shkresën nr. 2424, datë 10.10.2017, “Kërkesë për



hapjen e zyrave të deputetëve”, u komunikua zyrtarisht me prefekturat dhe bashkitë Elbasan, Berat dhe Durrës për të mundësuar vënien në dispozicion të ambienteve (një zyrë), si dhe prefekturat dhe bashkitë Tiranë, Dibër dhe Lezhë për nga dy zyra. Në përgjigje të këtyre shkresave u ofruan dy zyra në prefekturën e Dibrës dhe dy zyra në qarkun e Tiranës, përkatësisht në njësinë administrative nr. 6 (Kombinat) dhe njësinë administrative Dajt.

Kështu, krahas 10 zyrave që janë hapur në qarqet Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Shkodër, janë në proces për t’u bërë funksionale edhe 6 zyra të tjera.

Në kuadër të qëllimit për të cilin u hapën këto zyra, Kuvendi i Shqipërisë me mbështetjen e OSBE-së ka organizuar takime me deputetët dhe shoqërinë civile në Fier, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë. Vlen të theksohet organizimi i një seance dëgjimore publike e Komisionit parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Gjirokastrë, po ashtu dhe organizimi i parlamentit pilot me rreth 40 të rinj nga qarku i Korçës.

2. Trajnimi i administratës së Kuvendit

Për trajnimin e administratës së Kuvendit Byroja e Kuvendit ka miratuar një dokument bazë, që është “Strategjia e trajnimit të stafit të administratës së Kuvendit 2015–2018”. Për vitin kalendarik 2017 është hartuar plani i veprimit, në të cilin përcaktohen tematikat e trajnimit për gjithë shërbimet e Kuvendit. Për temat e trajnimeve që mbulohen nga ekspertë të jashtëm dhe për dërgimin e nëpunësve tanë jashtë vendit për trajnime apo këmbim përvojë gjatë vitit 2017 është miratuar një fond prej 1.600.000 lekësh. Një pjesë e konsiderueshme e temave të trajnimit të planifikuara nuk janë realizuar, kjo për arsye të ndryshme, por edhe për shkak të fillimit në muajin qershor 2017 të projektit të ri IPA. Përparësi kanë pasur trajnimet, takimet, seminarët, praktikat dhe shkëmbimi i përvojave në grupe të vogla ose individë.

Gjatë vitit 2017 kapacitetet administrative të Kuvendit janë forcuar më tej përmes trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht në ato që lidhen me procesin e integritetit evropian, konkretisht:

- 32 nëpunës të nivelit drejtues të administratës së Kuvendit morën pjesë në trajnimin me temë “*Lidershipi dhe menaxhimi organizativ*”, zhvilluar në muajin mars 2017;
- 17 nëpunës të Kuvendit të niveleve të ndryshme drejtuese morën pjesë në trajnimin e avancuar me temë “*Mbi metodologjitë tradicionale dhe të reja të kërkimit ligjor, shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe jurisprudencës*”, organizuar në datat 25–26 shtator 2017 në kuadër të zbatimit të projektit *Twinning*;
- 23 nëpunës civilë, staf i Shërbimit Legjislativ, Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës dhe zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm morën pjesë në aktivitetin trajnues “*Mbi rolin e parlamenteve kombëtare në procesin e integritetit evropian*”, që u zhvillua në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë në datat 11–12 dhjetor 2017 në kuadër të zbatimit të projektit *Twinning*.

Gjatë vitit 2017 kanë marrë pjesë në programe trajnimi të organizuara jashtë vendit, të ofruara nga organizma të ndryshëm (BE, OSBE, KiE NDI etj.), 28 nëpunës civilë të Kuvendit.

3. Implementimi i projektit të binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*” në kuadër të projektit IPA 2014 për Shqipërinë

Kapacitetet administrative të Kuvendit të Shqipërisë po forcohen më tej përmes implementimit të projektit të binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*” në kuadër të projektit IPA 2014 për Shqipërinë. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është



përmirësimi i funksioneve ligjvënëse dhe mbikëqyrëse të Kuvendit për përmbushjen efektive të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri dhe procesi i anëtarësimit në BE.

Ky projekt përbëhet nga 4 komponente:

1. Përmirësimi i procedurave ligjvënëse dhe i metodave të punës së Kuvendit për një proces më efektiv përafrimi të legjislationit me atë të BE-së.
2. Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Kuvendit mbi veprimtarinë e qeverisë dhe të institucioneve të pavarura.
3. Forcimi i pavarësisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit nga qeveria në përputhje me praktikat më të mira europiane.
4. Forcimi i transparencës dhe i kapaciteteve administrative të Kuvendit.

Ky projekt binjakëzimi po zbatohet nga parlamenti grek dhe ai italian dhe ka një vlerë prej 500 mijë eurosh. Zbatimi i këtij projekti binjakëzimi ka filluar në datën 5 maj 2017. Periudha e zbatimit të këtij projekti është 12 muaj (5 maj 2017–4 maj 2018), gjatë së cilës do të zbatuar 30 aktivitete sipas 4 komponenteve të projektit. Gjatë vitit 2017 janë zbatuar plotësisht 10 aktivitete të këtij projekti binjakëzimi si dhe ka filluar zbatimi i 7 aktiviteteve të tjera. Nga dhjetë aktivitetet e zbatuara gjatë vitit 2017 katër janë aktivitete të komponentit 1, një aktivitet i komponentit 2, një aktivitet i komponentit 3 dhe katër aktivitete të komponentit 4.

Veprimtaria njëvjeçare e Autoritetit të Ulët pranë Kuvendit të Shqipërisë

Autoriteti i Ulët pranë Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2017 e ka ushtruar detyrën në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr. 9367, datë 17.04.2005, ligjin nr. 9475, datë 9.02.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012, ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014 dhe ligjin nr. 42/2017, datë 6.04.2017.

Gjatë vitit 2017 është bërë njoftimi në kohë i subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit të pasurisë, duke sqaruar afatet ligjore që duhet të respektohen nga ana e tyre. Njoftimet për deklarimin e pasurisë janë bërë me shkresa zyrtare, bashkëlidhur të cilave është shpërndarë dhe një shpjegues, në të cilin detajohet mënyra e plotësimit të deklaratës së pasurisë.

Gjithashtu njoftimi është bërë edhe elektronikisht në adresat e tyre private dhe zyrtare, në të cilat janë dërguar edhe formularët e deklarimit të pasurisë për çdo subjekt.

Dorëzimi i formularëve të deklarimit periodik vjetor është bërë brenda afateve ligjore.

Nuk ka pasur raste që nuk janë zbatuar afatet kohore për dorëzimin e deklaratës së pasurisë.

Gjatë vitit 2017 kanë bërë deklarimin e pasurisë për herë të parë 77 subjekte, nga të cilat 66 deputetë dhe 11 nëpunës civilë.

Kanë bërë deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni 90 subjekte, nga të cilat 76 deputetë dhe 14 nëpunës civilë.

Gjithsej nga Kuvendi në vitin 2017 ishin 188 subjekte deklaruese, nga të cilat 127 deputetë dhe 61 nëpunës civilë.



PËRFUNDIME

Nga raportimi vjetor i punës së Kuvendit të Shqipërisë rezulton një zhvillim konstant dhe i qëndrueshëm në drejtim të:

- a) forcimit të funksionit ligjvënës të Kuvendit dhe rolit të tij mbikëqyrës;
- b) forcimit të bashkëpunimit dhe të monitorimit të institucioneve të pavarura;
- c) veprimit me efikasitet për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me qëllim garantimin e përafrimit më efektiv dhe me cilësi më të mirë;
- ç) forcimit të rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura për garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre;
- d) rritjes së perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe për një institucion plotësisht të hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm për rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit;
- e) zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht në ato që lidhen me forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, garantimin e transparencës parlamentare dhe me procesin e integritetit evropian.

Në zbatim të nenit 102 të Rregullores së Kuvendit, Shërbimet e Kuvendit edhe gjatë vitit 2017 kanë përmbushur detyrat e tyre këshillimore, informuese, organizative dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij për përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore.

Objektivat e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2018 do të jenë:

1. Forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit.
2. Forcimi i rolit mbikëqyrës Kuvendit përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.
3. Nxitja e mëtejshme e diplomacisë parlamentare përmes intensifikimit dhe forcimit të kontakteve dhe shkëmbimeve me parlamente të vendeve të tjera edhe përmes pjesëmarrjes në sesione parlamentare dhe takime të tjera të organizatave ku Shqipëria është palë.
4. Forcimi i kapaciteteve të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, me qëllim që ky institucion të përmbushë plotësisht rolin e tij si forum për përfshirje të gjerë dhe konsultime për çështjet e integritetit evropian.



5. Forcimi i transparencës parlamentare.

6. Forcimi i kapaciteteve të Kuvendit për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me qëllim që të garantohet një përafrim më efektiv dhe me cilësi më të mirë.

7. Forcimi i kapaciteteve administrative dhe i burimeve njerëzore.

